# AKT THEMELIMI

## I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " XHIMI" SHPK

### NENI 1

Z. Dhimitër Llazari lindur më 30.9.1953 në Himarë, banues në Tiranë lagja Nr.10, Rruga Shyqyri Peza, Pall.2 , Shkalla 1 , Ap.8 dhe Z. Vasilika Cinxo lindur më 28.4. 1959 në Tiranë, banuesn në Tiranë, Lagja Nr.10 , Rr. Shyqyri Peza, Pallati 2, Shkalla 1 , Ap.8 konform vullnetit të tyre të lirë dhe ligjit 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" , bien dakort të themelojnë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

### NENI 2

SH.P.K emërohet "Xhimi" me seli në Tiranë , Rr. Sh. Peza Pall. 2 shkalla 1 Ap. 8

Shoqëria do të zhvilloje veprimtarine ekonomike te saj mbi 10 vjet.

### NENI 3

SH.P.K. "XHIMI" është person juridik Shqiptar dhe aktiviteti e saj e ushtron në bazë të ligjit 7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare" si dhe statutit që bashkangjitet këtij akt themelimi.

Të drejtën e personit juridik e fiton më datën e rregjistrimittë saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë, në rregjistrin tregëtar dhe në Organet Financiare.

### NENI 4

Objekti i veprimtarisë së SH.P.K. "Xhimi" do të jetë:

Auto shkollë; oficine rriparim autemjetesh(servicio), transpo posagjerësh dhe mallrash,ivestime në fushën e prodhimitdhe turizmit, shërbime në fushën e turizmit, hotelerisë, restorant, bar, agjensi turistike, kambizëm, tregëti me shumicë dhe pakicë, pjesë këmbimi për autemjete, artikuj ushqimorë, industrialë, bujqësorë e blegtoralë, konfeksione, paisje elektroshtëpiake , lëndë drusore, vajra, karburant lubrifikante, bizhuteri, pije freskuese si dhe import eksport, prodhim dhe ambalazhim vaj ulliri, dhe sende ushqimore, ambalazhim pije alkolike ; blerje shitje dhënie me qira pasuri të patundëshme( shtëpi magazina, dyqane troje etj. ) ; krijim shoqëri të përbashkëta vëndase dhe të huaja në të gjitha drejtimet e mësipërme.

### NENI 5

Kapitali themelor është 100.000 lekë; ndarë në 100 pjesë me një vleftë për sejcilën pjesë me 1000 lekë.

Cdo ortak ka të drejtën e një vote për cdo 1000 lekë të kuotës. Dhimitër Vadhi Llazari depoziton 80 pjesë x 1000 = 80.000 lekë, baraz

me 80% të kapitalit themeler.
Vasilika Apostol Cinxo depoziton 20 pjesë X 1000 = 20.000 lekë, baraz me 20% të kapitalit themeler.

Në librin e llogarisë së shoqërisë krijohet fondi themeler i ortakëve ku shënohen kapitalet e vëna nga ortakët Dhimitër Llazari dhe Vasilika Cinxo.

Ortakët nuk kufizohen në rritjen e kontributit të tyre. Ai mund të rritet vetëm me vendim të asamblesë. Rritja e kapitalit me fonde të tjera financiare bëhet për të lejuar më mirë arritjen e objektivit të veprimtarisë së SH.P.K .

Shoqëria do të lëshojë një certifikatë sejcilit ortak që vërteton cilësinë e tija si ortak dhe vleftën e kuotës që ai zotëron.

NENI 6

Ortakët do të marrin pjesë në fitimin e shoqërisë në kuotën e pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e shoqërisë.

Fitimi bruto i realizuar nga SH.P.K " Xhimi" do ti nënështrohet taksave në masën që caktohet nga legjislacioni shqiptar.Pasi zbriten fondet që do të krijojë shoqëria ( fonde rezervë, fonde të vecanta financiare etj)fitimi që do të mbetet do të ndahet 80% për ortakun Dhimitër Llazari dhe 20% për ortakun Z. Vasilika Cinxo.

NENI 7

Shoqëria mund të hap dhe vëndqëndrime të tjera operative , filial përfaqësi , axhensi në të gjithë teritorin e Shqipërisë me miratimin e organeve përkatëse.

NENI 8

Veprimtaria ekonomike e SH.P.K "Xhimi" dhe investimet e saja garantohen dhe mbrohen nga shteti.

NENI 9

Shoqëria e pushon aktivitetin e saja me mbarimin e afatit të për caktuar në këtë akt themelimi, ose në cdo kohë tjetër për humbje kapitali, pamundësi veprimtarie dhe për shkaqe të tjera që gjykohen nga ortakët si të tilla.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria duke lajmëruar ortakun tjetër 30 ditë përpara. Lajmërimi bëhet me shkrim. Pushimi i aktivitetit të shoqërisë bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve.

NENI 10

Zgjidhja e mosmarëveshjeve që mund të lindin midis ortakëve dhe

që nuk mund të zgjidhen me anën e bisedimeve do ti nënshtrohen gjykimi në Gjykatën e RRethit Tiranë.

NENI 11

Organi drejtues i SH.P.K. "Xhimi" është asambleja e Ortakve.

Asambleja përfaqësen tërësine e ortakve. Aje mund të thirret në selinë e shoqërisë ose në një vënd tjetër të treguar në njoftimin e thirjes. Njoftimi duhet të përmbajë vëndin, ditën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.

Asambleja e ortakve zgjedh vetë presidentin. Asambleja e Ortakve vendos rregullisht me votën e ortakve.

Vendimet e asamblesë duhet te shënohen në proces verbal.

Vendimet e asamblesë duhet te merren me votim të hapur, ndërsa emërimi i pozitave shoqërore bëhet shprehimisht me gojë ose me votim të fshehtë.

NENI 12

Dispozita më të detajuara për shoqërinë tregëtare"Xhimi" SH.P.K. janë përcaktuar dhe në statutin e saj që bashkangjitet këtij akt-themelimi.

NENI 13

Ky akt themelimi është hartuar në pesë kopje në të njëjtën vlerë Njëra kopje depozitohet në Gjykatën e Tiranës, një kpje në noteri, një kopje jepet sejcilit ortak, dhe një kopje në Zyrën e Tatimeve.

O R T A K Ë T

Dhimitër Vadhi LLazari    Vasilika Apostol Cinxo

REPUBIKA E SHQIPËRISË
NOTERIA TIRANË
Nr 57 Rep
Nr 16 Koli

V Ë R T E T I M

Sot më datën 1995 ne Zyrën e Noterisë Tiranë u paraqit personalisht Dhimitër LLazari i biri i Vadhit datëlindja 30.9.1953, banues në Tiranë me zotësi të plotë për të vepruar me letër njoftimi QH Nr 291208 dhe Z. Vasilika Cinxo e bija e Apostolit datëlindja 28.4.1959, banues në Tiranë me zotësi të plotë për të vepruar, me letër njoftimi EV Nr 207616.

Për sa më sipër u sigurova nga letër njeftimet që më paraqitën dhe më deklaruan se janë dakort me këtë akt themelimi të SH.P.K. "XHIMI" të hartuar jashtë kësaj zyre dhe nënshkruan rregullisht para meje, noteres. Edhe unë noterja duke gjetur veprimin e mësipërm te mbështetur n ligj e vërtetoj dhe nënshkruaj.

N O T E R E

(Kimete Peza )

# S T A T U T

## PËR VEPRIMTARINË EKONOMIKE SH.P.K. "XHIMI "

SH.P.K. "Xhimi" është krijuar në bazë të akt themelimit që i bashkangjitet këtij statuti ndërmjet ortakve Z. Dhimitër LLazari nga njëra ana dhe nga ana tjetër Z. Vasilika Cinxe.

Të dy ortakët u morren vesh dhe hartuan statutin si më poshtë vijon:

NENI 1

SH.P.K. "Xhimi" është person juridik shqipëtar në bazë të dekret ligjit Nr 7638 datë 19.11.1992"Për shoqërtitë tregëtare".

SH.P.K Fiton të drejtën e personit juridik më datën e rregjistrimit në gjykatën e rrethit Tiranë.

Shoqëria ka vulën dhe intestimin e saj të përcaktuar sipas, vullnetit të administraterit dhe në përputhje me normat ligjore.

NENI 2

Seqëria tregtare SH.P.K " Xhimi": zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dokumentat e krijimit ( akt themelimi dhe statut).

NENI 3

Shoqëria tregtare SH.P.K "Xhimi" ka selinë e saj në Republikën e Shqipërisë në Tiranë Lagja Nr.10 Rruga SH.Peza Pall.2 Shkalla 1 Ap.8 Aje mund të celë filiale , degë, përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë. Degët , filialet, përfaqësitë e saje krijohen në përputhje me lëgjislacionin shqiptar.

NENI 4

Shoqëria tregtare përgjigjet për detyrimet e saje me fondet e veta.

NENI 5

Ortakëtgëzojnë këte të drejta kryesore;

- Administrimin e veprimtarisë së shoqërisë tregtare në përputhje me akt themelimin dhe statutin.
- Pjesmarrjen në rezultatet e ode forme e sasie të veprimtarisë së shoqërisë tregtare parashikuar në akt themelimin dhe statutin e saj.
- Marrjen e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me gjëndjen ekonomike treğtare dhe me veprimtarinë e shoqërisë tregtare si bilanca dhe llogaritë ekonomike?
- Heqjen dorë nga shoqëria tregtare duke i a ofruar kuotën e vet sipas zgjedhjes ortakut tjetër. Kur nuk bëhet një zgjidhje e tillë nga ortaku tjetër kuota mund tu cedohet të tretëve.

NENI 6

Ortekët kanë detyrimet kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre dhe kuotet suplimentare në përputhje me akt themelimin dhe statutin.

- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë tregtare nëpërmjet organeve të krijuara nga ana e vet.

- Të kryejnë detyrat për realizimin e objektit dhe të funksione të shoqërisë tregtare.

NENI 7

Sejcili ortak ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria tregtare duke i njoftuar vendimin e tij asamblesë së ortakëve një vit përpara. Heqja dorë nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra më para ndaj shoqërisë tregtare dhe nuk pezullon detyrimet e shoqërisë tregtare ndaj ortakut.

Ortaku dorëheqës duhet ti afrojë aksionet e tija ortakut tjetër dhe kur ky i fundit nuk e pranon këtë blerje ortaku dorëheqës brënda 30 ditëve nga njoftimi i dorëheqjes mund tu a shesë aksionet e tij të tretëve por jo me çmim më të ulët nga si i ofruar ortakut.

NENI 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare SH.P.K "Xhimi " realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saja.

NENI 9

Ortekët marrin pjesë në krijimin e kapitalit bazë të shoqërisë tregtare me kuotat e tyre që përcaktohen në akt themelimin për krijimin e shoqërisë tregtare ( i ndarë në 100 kuota nga 1000 lekë )

Asambleja e ortakëve u dorëzon palëve një dokument me të cilën vërtetohet derdhja e shumave prej tyre.

NENI 10

Shoqëria tregtare SH.P.K"XHimi" pushon veprimtarinë e saj pasi shlyen të gjithe detyrimet që ka . Pjesën e mbetur të kapitalit dhe tëtë ardhurave ja ndan ortakëve në përpjestim me kuotën e vënë prej sejcili ortak për krijimin e kapitalit bazë të shoqërisë.

NENI 11

Shoqëria tregtare SH.P.K "Xhimi" gëzon të drejtat për mbrojtjen e pasurive të saja në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 12

Shoqëria tregtare disponon plotësisht mjetet e saja financiare. Detyrimet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saja , mbulohen nga fondi rezervë dhe nga fondet e tjera ose nga shuma suplimentare që mund të derdhin ortakët, kur detyrimet nuk mund të mbulohen nga fo ekzistuese. Të ardhurat neto pasi lihet mënjanë një shumë jo më

se 5 % për rrezervën e nevojshme e cila nuk duhet te jetë më shumë se 10% e kapitalit shoqëror ( neni 213 i ligjit 7638/92 ) shpërndahet ndërmjet ortakve.

NENI 13

E ardhura bruto e shoqërisë tregëtare pasi zbriten fondet rezerv dhe fondet e tjera dhe tatimet pjesa që mbetet ndahet ndërmjet ortakve në përpjestim me kuotën e pjesmarjes në kapitalin bazë të shoqërisë.

NENI 14

Organi legjislativ i shoqërisë tregëtare SH.P.K. "XHimi" është asambleja e ortakve. Në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, sipas madhësisë së shumave të vëna për krijimin e kapitalit bazë të shoqërisë tregëtare, 80 përqind për Dhimitër LLazarin dhe 20 përqind për Vasilka Cinxen.

Asambleja e ortakve vendos për bilancin vjetor për ndryshimet n statut për shtimin ose paksimin e kapitalit bazë të shoqërisë tregëtare, për emërimin e ekspertit kontabël, për pushimin e shoqërisë tregëtre.

Uniteti në vendimet e asamblesë së ortakve është i nevojshëm për këto cështje:

-Ndryshimi istatutit

-Zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë tregëtare.

-Pushimi i veprimtarisë së shoqërisë tregëtare.

- Rritjen ose paksimin e kapitalit bazë.

-Për fimin nga rezultatet.

Në asamblenë e ortakve secila kuotë përfaqësohet nga një votë

Asambleja e ortakve të shoqërisë tregëtare thirret së paku një herë në vit duke lajmëruar me shkrim 30 ditë përpara.

NENI 15

SH.PK. "Xhimi" ka president Z.Dhimitër Llazari dhe administrat tore Z.Vasilika Cinxo.

Në mardhënje me të trtët administratorja ka të gjitha kopetencat për të kryer veprimet në interes te shoqërisë dhe në emër të saj që janë në përputhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të atyre që janë në kopetencë të asamblesë të ortakve që u jep ky statut dhe legjislacioni në fuqi.

Administratorja përfaqësen shoqërinë si para organeve administrative, tatimore, gjyqësore dhe të tretve, personalisht.

NENI 16

Asambleja e ortakve cakton ekspertin kontabël. Eksperti kontabël është përgjegjës për veprimtarinë e tij para asamblesë së ortakve, për dokumentimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe për konkluzion për bilancet vjetore. Bilanci i shoqërisë do të shoqërohet me një relacion.

Veprimtaria e shoqërisë mbyllet më datën 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 17

Marrëdhëniet e punës në shoqërinë tregtare, filiale, degë ose në përf
qësi rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

NENI 18.

Veprimtaria e SH.P.K "Xhimi" pushon në kohën e përcaktuar në aktin e themelimit ose më parë sipas propozimit të bërë nga njëri prej ortakëv kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentabël si dhe në të gjitha rastet që parashikohen në dokumentin e krijimit të shoqërisë tregtare, aktit të themelimit.

NENI 19

Me puchimin e veprimtarisë së SH.P.K " Xhimi" mjetet finanaciare të fi tuara si rrezultat i veprimtarisë së SH.P.K " Xhimi" ndahen ndërmjet ortakëve në përpjestim me kuotat e vëna pasi të jenë bërë pageset pë kreditorët.

NENI 20

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin gjatë ekzekutimit të këtij statuti, gjatë ekzistencës së shoqërisë, gjatë kryejes së veprimtaris oshtu dhe në procesin e likujdimit ndërmjet ortakëve në qoftëse ato nuk do të zgjidhen me mirëkuptim , ortakët do ti drejtohen për gjykim Gjykatës së Rrethit Tiranë.

NENI 21

Ky statut hyn në fuqi ditën e firmosjes nga ortakët dhe rregjistrimit të tij.

NENI 22

Ky statut është hartuer në 5 kopje me të njëjtën vlerë.
Njëra kopje depozitohet në gjykatën e Tiranës, një kopje në noter një kopje jepet sejcilit ortak dhe një kopje në zyrën e tatimeve.

O R T A K Ë T

Dhimitër Vadhi Llazari

[signature]

Vasilika Apostol Cinxe

[signature]

REPUBLIKA SHQIPËRISË
NOTERIA TIRANË
Nr. 57 Rep
Nr. 16 Koli

V Ë R T E T I M

Sot më datën 1995 në zyrën e noterisë Tiranë u paraqitën personalisht Z. Dhimitër Llazari i biri i Vedhit datëlindje 30.9.19

1953, banues në Tiranë me zotësi të plotë për të vepruar, me letër njoftimi QH Nr 291208 dhe Z. Vasilike Cinxo, e bija e Apostolit, datëlindja 28.4.1959, banues në Tiranë me zotësi të plotë për të vepruar me letër njoftimi EV Nr 2076DG (207616).

Për sa më sipër u sigurova nga letër njoftimet që më paraqitën dhe më deklaruan se janë dakort me këtë statut të Sh.P.K. "Xhimi" te hartuar jashtë kësaj zyre dhe nënshkruan rregullisht para meje, nëter

Edhe unë noterja duke gjetur veprimin e mësipërm të mbështetur në ligj e vërtetoj dhe e nënshkruaj.

N O T E R E

( Kimete Feza )